LIGJ
Nr. 56/2025

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR. 7764, DATË 2.11.1993,
"PËR INVESTIMET E HUAJA", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika l, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7764, datë 2.11.1993, "Për investimet e huaja", i ndryshuar, bëhet shtesa si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 10 shtohet paragrafi 2, me këtë përmbajtje:
"Investimet e huaja direkte, që lidhen apo ndikojnë mbi infrastrukturën publike kritike, teknologjinë kritike dhe mallrat me përdorim të dyfishtë, furnizimin me inpute kritike, aksesin në informacionin sensitiv ose mbi lirinë e medias, sipas përcaktimeve të rregullores (EU) 2019/452 të Parlamentit Europian dhe Këshillit të Bashkimit Evropian, i nënshtrohen një vlerësimi apo shqyrtimi sipas rregullave dhe procedurave të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 3.7.2025.

Shpallur me dekretin nr.229, datë 9.7.2025 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj